

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 ODLIKA JE PRAVNOSNAZNA **NË EMËR TË POPULLIT**  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni**

penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED], për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.218-1/14 të datës 05.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt. 20.09.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, si dhe të akuzuarit [REDACTED] të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari,

[REDACTED], nga [REDACTED], rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor në kompanin [REDACTED] në Babush të Ferizajt, me nr.personal [REDACTED].

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 24.01.2014, rreth orës 14:30, te salla e sportit “Bill Klintoni” në Ferizaj të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] ndalen nga policia për kontroll dhe gjate kontrollit tek i pandehuri [REDACTED] është gjetur një qese e vogë me substancë të dyshuar të llojit marihuanë me peshë 047 gr, ndërsa tek i pandehuri [REDACTED] i është gjetur një qese e vogël me substancë të dyshuar narkotike në peshë prej 0.41 gr, të cilën në mënyrë të pa autorizuar e ka poseduar me ç’rast ju konfiskohet përkohësisht nga policia.

**me të cilën kreu veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,6,7,21,31,41,43,45, 46 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

### **GJYKON**

Të pandehurin [REDAKTUAR], **me DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të pandehurit nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) €, i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, substanca narkotike bimore me ngjyrë të gjelbërt e llojit kanabis (Marihuanë) që përmbanë Terahidrokanabinol (THC) me peshë 0.88 gram, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Obligohet i akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.218-1/14 të datës 05.05.2014 i ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] e [REDAKTUAR] për veprën penale posedimi i pa



autorizuar i narkotikëve, substancav psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare me aktvendimin P.nr.492/14 të datës 20.09.2017 ka veçuar procedurën penale kundër të pandehurit [REDACTED].

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor më dt. 20.09.2017 vetëm ndaj te pandehurit [REDACTED] me të cilin Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini, pas leximit te akuzës ka deklaruar s mbetet pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik te saj duke deklaruar qe i pandehuri te shpallet fajtor dhe ti shqiptohet nj e sanksion penal i parapar me ligj.

I pandehuri [REDACTED], ne shqyrtimin gjyqësor , me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se kam qenë i ri dhe nuk i kam ditur pasojat.

Me që i pandehuri [REDACTED] ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: deklaratat e te pandehurit [REDACTED] e dt.24.01.2014, deklarata e te pandehurit [REDACTED] e dt.24.01.2014, deklarata e dëshmitarit [REDACTED] e dt.27.01.2014, vërtetimi mbin sekuestrimine përkohshëm te sendeve nga i pandehuri [REDACTED] i dt.24.01.2017, raporti i ekspertizës nr.AKF/2014-0619/2014-499 i dt.21.03.2014 si dhe fotografit

dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese, për te pandehurin mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori peshën e veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të pandehurit i vërtetoi dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) Euro, i cili dënim do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.



Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, substanca narkotike bimore me ngjyrë të gjelbërt e llojit kanabis (Marihuanë) që përmbanë Terahidrokanabinol (THC) me peshë 0.88 gram, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni  
penal, P.nr.492/14, dt.20.09.2017**

**Sekretarja Juridike ,**  
Drita Ujupi



**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej  
15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të  
kësaj gjykate.